

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

1314/ Prot.

2

Tiranë, më 24.02.2014

URDHËR

Nr. 43/ datë 24.2.2014

1

PËR

EMËRIM TË PËRKOHSHËM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 173, datë 07.03.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit", të Vendimit Nr. 545, datë 11.08.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucione në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", të Vendimit Nr. 303, datë 01.07.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Sistemit të Akreditimit të Arsimit të Lartë" dhe të Urdhrit Nr. 171, datë 27.09.2010, Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë",

URDHËROJ:

1. Znj. Dhurata BOZO, të emërohet përkohësisht në pozicionin: Drejtor në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), deri në përfundimin e procedurave të konkurrimit për këtë pozicion.
2. Marrëdhëniet financiare në këtë detyrë t'i fillojnë më 24.02.2014.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, në MAS.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

